



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 178/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega Prizren, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e parakoshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega Prizren i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 1050 ( njëmijë e pesëdhjetë ) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### Arsyetim

Me datën 05.06.2014, LVV, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se, me datë 04.06.2014, diku rreth orës 14:05 aktivistja Marigone Drevinja e LVV-së, ka vërejtur se në rrugën “Adem Jashari” në komunën e Prizrenit, ishte vendosur baneri mbi rrugë publike i kandidatit për Kuvendin e Kosovës Hatim Baxhaku nga subjekti politik LDK-së. Sipas parashtruesit të ankesës në kuptim të dispozitës së nenit 4.1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013 vendosja e banerit mbi rrugë publike përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës ka ofruar një fotografi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik- Lidhjen Demokratike të Kosovës -, me datën 05.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.06.2014 deri në ora 17:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë sipas afatit të caktuar, në të cilën përgjigje është theksuar se subjekti politik LDK, ka ndërmarr të gjitha masat e parapara për evitimin e shkeljes së pretenduar, duke e argumentuar më fotografi të ofruar si dëshmi për largimin e banerit në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjindet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatit për Kuvendin e Kosovës Hatim Baxhaku nga radhët e subjektit

politik LDK, ishte vendosur mbi rrugë publike në rrugën “Adem Jashari” – në Prizren, veprim ky i cili është në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika (b) të LZP-së, të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Gjatë përcaktimit të shumës së përshtatshme për gjorbitjen e ndonjë subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë
- Masat, nëse ka pasur fare të tilla, të cilat janë ndërmarrë apo miratuar nga subjekti politik për të parandaluar shkelje të ligjeve përkatëse zgjedhore në Kosovë;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në ndonjë palë zgjedhje në të kaluarën.

PZAP-i, mori parasysh si rrethanat rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese, si rrethanë rënduese mori se subjekti politik në fjalë ka marr pjesë në të gjitha zgjedhjet e mbajtura deri më tani në Kosovë dhe se supozohet se janë të njoftuar plotësisht më procesin zgjedhor dhe se i njëjti subjekt politik ka përsëritur shkelejn e të njëjtës natyrë si në këto zgjedhje poashtu edhe në zgjedhjet e kaluara.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese mori parasysh faktin që subjekti politik LDK, pas marrjes së Kërkesës për Përgjigje në ankesë dhe pas dhënies së urdhërit nga PZAP-i, për ta evituar shkelejn e pretenduar në ankesë, subjekti në fjalë i ka ndërmarr të gjitha masat për përmirësimin e shklejes së supozuar, e cila çështje ka ndikuar në uljen e lartësisë së gjobës të shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi ngase sipas Rregullorës Nr. 01/2012 të PZAP-it për “Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobjave”, gjoba lidhur më shkeljen e pretenduar në ankesë është 5100 euro.

PZAP-i, duke u bazuar në shkresat e lëndës konstatoi se subjekti politik LDK, ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili parasheh se “*Është e ndaluar vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve ose vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në apo mbi rrugët publike gjatë fushatës zgjedhore*” dhe poashtu duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 178/2014 më datën 08.06.2014.



#### ***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*